

V E N D I M
Nr. 173, datë 13.4.2000

**PËR LEJIMIN E EKSPOZIMIT TË NJË VËLLIMI ORIGJINAL, TË RESTAURUAR TË
“CODEX BERATINUS PURPUREUS” (SHEKULLI VI)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 22, pika 3, të ligjit nr.7726, datë 29.6.1993, “Për fondin arkivor kombëtar dhe për arkivat”, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të marrë pjesë në ekspozitën ndërkombëtare “Ungjijtë e popujve”, në Vatikan, me një vëllim origjinal, të restauruar të “CODEX BERATINUS PURPUREUS” (shek VI.).

2. Kodiku të qëndrojë i ekspozuar dy muaj.

3. Kushtet dhe kërkesat për sigurimin, gjatë transportit, të Kodikut dhe koha e ekspozimit të përcaktohen në kontratën e nënshkruar ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave dhe Bibliotekës Apostolike të Vatikanit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta